

Nr. 2302/10 K (e-k) Prot.
Tiranë, më datë 17/02/2023

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
z. Ilirjan CELIBASHI

Lënda: REKOMANDIM – Për shtyrjen e
vendimmarrjes lidhur me
projekt-vendimin “Për
shpërndarjen e fondeve vjetore
partive politike në formën e
ndihmës financiare vjetore për
vitin 2023”

I Nderuar Z. Komisioner!

Të nderuar kolegë të administratës së KQZ-së!

Në kuadër të gjithë bashkëpunimit me ju lidhur me konsultimin paraprak të projekt-akteve të ndryshme, për të cilin gjejmë rastin t’ju falënderojmë sërish, KRIIK ju paraqet shkurtimisht qëndrimin e tij lidhur me mënyrën e parashikuar për shpërndarjen e fondeve vjetore ndaj partive politike për vitin 2023.

Në gjykimin e KRIIK, ka një paqartësi lidhur me parashikimet ligjore aktuale në ligjin e partive politike me ndryshimet e bëra në Kodin Zgjedhor në tetor 2020, si pasojë e ndryshimeve kushtetuese të korrikut 2020, mbi mënyrën e garimit si koalicion në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare.

Në mungesë të kohës së mjaftueshme për një analizë të plotë, si dhe të kopjes së marrëveshjes së Koalicionit “PD-AN” për zgjedhjet parlamentare të vitit 2021, **sugjerohet që KQZ, ta shtyjë vendimmarrjen e saj lidhur me këtë projekt-vendim, për një analizë më të plotë të argumentimit të bërë dhe precedentit që mund të krijohet.**

Neni 19 i ligjit “Për partitë politike”, i cili parashikon mënyrën e shpërndarjes së fondeve vjetore ndaj partive politike, është ndryshuar më datën 10.02.2011 dhe kuptimi i pikës 2 gërma “a” tek ky nen i referohet rregullimit dhe kontekstit ligjor të asaj kohe.

Sipas KRIIK, mbështetja financiare nuk është gjë tjetër veçse mbështetja në para nga buxheti i shtetit për partitë politike të cilat garojnë në zgjedhje dhe fitojnë një numër të caktuar mandatesh sipas rregullave të paracaktuara.

Masa e mbështetjes nga sovranit, e përkthyer në numër mandatesh parlamentare është sipas rezultatit të dalë dhe fotografisë së shpërndarjes së mandateve të përfaqësimit parlamentar të bëra në përfundim të procesit zgjedhor nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Në gjykimin e KRIIK, **vetëm kjo shpërndarje mandatesh përfaqësimi parlamentar ka legjitimitetin e plotë të votuesit/sovranit**, e cila përkthehet më pas në mbështetje financiare vjetore për partitë respektive, sipas parashikimeve ligjore.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Mënyrat e lëvizjes së një apo më shumë mandateve më pas, sipas procedurave të tjera të ligjshme apo edhe marrëveshjet paraprake që mund të jenë bërë, nuk mund të rrëzojnë këtë verdikt dhe mbështetje të sovranit për forcën politike apo koalicionin, e cila është përkthyer në mandate përfaqësimi parlamentar në momentin e përlllogaritjes së bërë bazuar në rezultatin e final të votave të marra, sipas sistemit zgjedhor.

Çdo ndryshim i mëvonshëm nuk mund të zhbëjë këtë vullnet përfaqësimi, e rrjedhimisht edhe mbështetjen financiare vjetore e cila duhet të jepet nga buxheti i shtetit për katër vitet e ardhshme bazuar vetëm në këtë fotografi të përfaqësimit parlamentar menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare, në rastin konkret, atyre të vitit 2021.

Marrja në konsideratë e ndryshimeve të mëvonshme në numrin e mandateve parlamentare, për efekt të mbështetjes vjetore financiare të partive politike, në gjykimin e KRIIK, është e pasaktë, madje lë shteg dhe krijon precedent negativ, që nuk pasqyrojnë vullnetin e sovranit, por e bën atë pre të makinacioneve ligjore apo politike.

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi,

Me konsideratë,

***Për Koalicionin Për Reforma, Integrim
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)***

**Premto Gogo
Kryetar**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania